



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



01-2654

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-0283691/18 dt. 30.11.2018, të pronarit **Hazir (Beqir) Berishës** nga fsh. Siçevë, p.nr. për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e fermës për ruajtjen e derrave, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me dt. 23.04.2019, merr këtë

## V E N D I M

### PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

**I. I Caktohen kushtet ndërtimore** pronarit **Hazir (Beqir) Berishës** nga fsh. Siçevë, p.nr. sipas kërkesës 05 nr. 350/02-0283691/18 dt. 30.11.2018, kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e fermës për ruajtjen e derrave me cca 90 krerë, me gabarit 25.0 m' x 12.0 m', dhe etazhitet P+0, në kuadër të parcelës kadastrale nr.73-0 ZK Siçevë, e cila shtrihet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal.

**II. Lokacioni** i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-156871 dt. 27.08.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e paraparë për ndërtim me një pjesë jashtë zonës së ndërtimit të këtij fshati, mirëpo sipas kushteve për ndërtimin e ndërtesave në zonën rurale, me një trajtim të veçantë nga sektorët përkatës të Komunës së Prishtinës (Sektori për Mjedis, Drejtoria për Ekonomi etj.) pjesë e së cilës është edhe pjesa e parcelës kadastrale nr.73-0 ZK Siçevë. Lidhur me këtë dhe me parametrat e ndërtimit nga ky plan, pronari është informuar me shkresën "Informim" me referencë nr. 04-070/01-196221/18 dt.10.08.2018, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

**III. Gjendja ekzistuese e lokacionit** - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, gjendjes faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është: parcela kadastrale nr. 73-0 ZK Siçevë, me sipërfaqe  $S=3.241,0 \text{ m}^2$ ; me pronar Hazir Berishën; “arë e klasës 7”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Bazuar në certifikatën e njësisë kadastrale, parcela kadastrale nr.73-0 është tokë bujqësore “arë e klasës 7”;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 73-0 ZK Siçevë, nuk ka ndërtesa tjera;
- Është tokë me infrastrukturë të pjesëshme: ka rrugë, ujësjellës dhe elektrikë;
- Terreni ka pjerrtësi të vogël, kah ana lindore;
- Parcela ka qasje në rrugën lokale ekzistuese;
- Në diametër prej 50 m' ka dy ndërtesa ekzistuese, me destinim banimor dhe ekonomik/bujqësor.

Faqe 1 nga 6

- IV. Kushtet ndërtimore** për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për ndërtimin e fermës për ruajtjen e derrave, në Siqevë, bazuar në parametrat urban të planit PZHK, janë:
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesës, sipas PZHK-së dhe sipas projektit të prezantuar është “bujqësor/ekonomik” konkretisht ruajtja dhe rritja e derrave;
  - Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - “zgjidhja urbane”, bashkëngjitur këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
  - Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore-brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë të përdhësës ose suterren, sipas PZHK-së është max. 30 %;
  - Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas PZHK-së është P+0, i propozuar dhe i miratuar është P+0;
  - Distanca në mes të vijës ndërtimore dhe vijës rregulluese sipas kushteve nga PZHK duhet të jetë 3.00÷5.00 m', ndërsa në mes të ndërtesave individuale për banim duhet të jetë 5.00-10.00 m';
  - Qasja në parcelë të jetë nga rruga ekzistuese, siq është paraqitur në Planin e situacionit - “zgjidhja urbane” e parcelës;
  - Bazuar në kriteret e PZHK-së, distanca minimale në mes objekteve individuale është 5-10 m', ndërsa me objektet ekonomike apo ndihmëse është 25-30 m';
  - Në paraqitjen e situacionit të parcelës kadastrale, të paraqiten edhe organizimi i vendparkimeve të jashtme, rrugëve përreth parcelës, gjelbërimit të planifikuar, etj;
  - Ndërtimi i fermës duhet të bëhet sipas standardeve të aprovuara nga MBPZHR ("Planit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007-13"), duke paraparë edhe infrastrukturën përcjellëse (dezbarijerën, bunarin, hapësirën rezervë, bazenin për plehra, gropën septike në anën e kundërt të bunarit, pajisjet për pregaditjen e ushqimit të koncentruar dhe racioneve të kafshëve, etj.)
  - Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- V. Kyçja në infrastrukturë** - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina”, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:
- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
  - Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
  - Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
  - Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
  - Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).
- VI. Dokumentacioni ndërtimor** - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normat teknike për siguri nga zjarri, si dhe normat dhe standardet tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) formë digjitale, dhe të përmbajë:
- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
  - Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50 m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
  - Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale / kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;

- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdheshë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratat nga projektuesit e fazave të nevojshme për hartimin e Projektit Kryesor, Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3)kopje në formë të shkruar dhe një (1) elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- të ndërtimit, i cili do të jetë konform Kodit të Ndërtimit dhe rregulloreve teknike në fuqi.

**VII. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.**

*Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:*

Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

**VIII. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcela kadastrale nr. 73-0 ZK Siçevë në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar si kulturë “arë e klasës 7”, dhe pasi që, për Planin Zhvillimor Komunal nuk është marrë pëlqim nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, për inicim të procedurës, kërkohet paraprakisht ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, për parcelën e paraparë për ndërtim, konform dispozitave ligjore të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që rregullojnë këtë fushë. Për pajisje me këtë pëlqim, me kërkesë duhet t’i drejtoheni kësaj drejtorie, me dokumentacionin e nevojshëm, e cila përmes aktit përcjellës do të procedohet në kompetencë në Drejtorinë e Bujqësisë të Komunës së Prishtinës. Për pajisje me këtë pëlqim, me kërkesë duhet t’i drejtoheni kësaj Drejtorie, me dokumentacionin e nevojshëm, e cila përmes aktit përcjellës, do të procedohet, në kompetencë në Drejtorinë e Bujqësisë të Komunës së Prishtinës.

Dokumentacioni i nevojshëm duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, i lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit.

**IX. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore** - meqenëse parcela kadastrale 73-0 ZK Siçevë, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës si tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “arë e klasës 7”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të UA të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

- Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do t’i ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit – “zgjdhja urbane”, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore prej  $S=700.0 \text{ m}^2$ .

Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Ky kompensim – pagesë, do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**X. Marrëveshja për infrastrukturë** – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse do të prezantohet në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës/ave dhe investitorit).

**XI. Pagesa e taksës administrative** për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 Nr. 434/01 – 0094474/17 dt. 24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese, në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, sipas pikës 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënimin.

**XII. Vlefshmëria** e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimin për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

## A r s y e t i m

Pronari **Hazir (Beqir) Berisha** nga fsh. Siçevë, p.nr. me kërkesën 05 nr. 350/02-0283691/18 dt. 30.11.2018, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e fermës për ruajtjen e derrave për cca 90 krerë, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Me kërkesë, pronari ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Kopjen e planit për parcelën nr.73-0 të evidentuar në Certifikatën e njësisë Kadastrale P-71914064-00073-0 ZK Siçevë;
- Informimin nga P.Zh.K. nr.04-070/01-196221/18 me dt. 10.08.2018, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm;
- Incizimin gjeodezik të punuar nga gjeodeti Faton Bajselmani, me Licencë nr.125 dt. 23.08.2018, me fotografitë nga terreni i lokacionit.
- Letër Informim – Miratimi i projektit nga MBPZhR me nr. 6953 dt. 30.10.2018, me Kontratën për financimin e projekteve investuese të zhvillimit rural nr. 625/2018, e lidhur me Burim Berishën;
- Pëlqimin për shfrytëzim të kësaj parcele nga përfituesi Burim Berisha në kohë të pacaktuar, e vërtetuar te noteri Isak H. Ademi LRP.nr. 6509/19 dt. 23.04.2019;
- Vërtetimin e tatimit në pronë nr. 277703/18 dt. 21.11.2018 lëshuar nga Drejtoria e Financave;
- Projektin konceptual/ideor për parcelën kadastrale në fjalë, të hartuar nga Sh.p.k. “KAHN & Z” nga Prishtina, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 810108052 dt. 28.03.2018;
- Fotokopjet e letërnjoftimeve të pronarit dhe përfituesit.

Në procedurë të shqyrtimit të kësaj kërkesë, përmes shkresës zyrtare “Plotësim dokumentacioni” 05 nr. 350/02-0283691/18 dt. 05.12.2018, nga pronari është kërkuar të bëjë plotësimin e dokumentacionit, gjegjësisht të sjellë Situacionin/dispozitën e lokacionit. Me shkresën 05 nr. 350/02-0283691/18/1 dt. 19.12.2018, aplikuesi ka sjellë situacionin i cili nuk ka qenë i kompletuar me përmbajtjen e kërkuar, andaj me shkresën “Plotësim dokumentacioni” 05 nr. 350/02-0283691/18 dt. 20.12.2018, për herë të dytë është kërkuar të bëjë plotësimin e duhur, të cilën e realizoi përmes shkresës 05 nr. 350/02-0283691 /18/2 me dt. 28.12.2018.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 350/02-0283691/18 dt. 30.11.2018, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe projektit konceptual të prezantuar, ka konstatuar se ky projekt është në harmoni me UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, me kriteret e PZhK-së për atë hapësirë, prandaj kjo drejtori, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017, ka vendosur Njoftimin publik me dt. 08.01.2019. Ky njoftim, sipas rregulla-tivës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë, dhe meqenëse në ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Mirëpo, gjatë shqyrtimit të lëndës është konstatuar se si pronar i kësaj parcele ka qenë i regjistruar i ati i ndjerë Beqir Berisha, andaj, deri në rregullimin e çështjes së pronësisë, kjo kërkesë është pezulluar me Vendimin 05 nr. 350/02-0283691/18 dt. 19.02.2019.

Pas rregullimit të pronësisë me dt. 16.04.2019 në emër të Hazir Berishës, dhe marrjes së pëlqimit së lidhur mes tij dhe përfituesit të grantit Burim Berishës (i biri i Hazirit) nga MBPZhR, me kërkesën 05 nr. 351/05-90385/19 dt. 18.04.2019, pronari i ri i kësaj kërkesë, aplikoi për vazhdimin e procedurës për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor për ndërtimin e fermës për ruajtjen e derrave, gjegjësisht ndërprejten e Vendimit për pezullim 05 nr. 350/02-0283691/18 dt. 19.02.2019.

Bazuar në konstatimet e mësipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të PZHk-së për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, prandaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të Vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.


**Shtojcë:** - Plani i situacionit - "Zgjidhja urbane",  
- Incizimi gjeodezik me propozimin e sipërfaqes për ndërrimin e destinimit të kulturës.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund t'i drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror - MMPH-ja.

**I dërgohet:** Kërkesit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Drejtorisë së Kadastrit, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie, dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
**05 Nr. 350/02-0283691/18 dt. 23.04.2019**

Punoi:  
Sh. Gorani



U.D. Udhëheqëse e sektorit:  
Lindita Beqiri





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 73-0


Zona kadastrale / Katastarska zona: Siqeve

Numri i lëndës / Broj predmeta: \_\_\_\_\_

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 500

Koordinatat ku ndërtohet shtalla		
Nr	y	x
1	7517489.646	4733231.654
2	7517466.98	4733222.98
3	7517480.969	4733195.421
4	7517500.038	4733202.112
5	7517498.903	4733206.928
6	7517494.893	4733218.158



Rilevoi / Snimio: Faton Bajselmani  
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanije)

Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: 125

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi / Potpis: F. Baj

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_

Data e rilevimit / Datum snimanja: 24.01.2019



